



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2304 / Prot.
/ 3.2

Patos, më 01 / 11 / 2022

PROCES-VERBAL

I mbajtur sot në datë 26.10.2022 ora 10:00 në fshatin Gjinoqarë Njësia Administrative Ruzhdie, ku organizohet dëgjesa publike **me temë :“Prezantimi i Paketës Fiskale 2023**, sipas pikën nr. 10, të kalendarit të përgatitjes së PBA-së 2023-2025, Miratuar me VKB-në Nr.70 datë 14.12.2021

Marrin pjesë në këtë takim konsultativ:

Pjesëmarrës në këtë takim konsultativ janë:

1. Kryetar të fshatrave të Njesisë Ruzhdie
2. Administratori i Njesisë Ruzhdie
3. Banorë të Njësë Administrative
4. Perfaqesues te shoqerise civile
5. Koordinator i të drejtës për Informin dhe Konsultimit Publik
6. Përfaqësues të ekzekutivit

Takimi hapet nga Sekrettar i Këshillit z. Balil Balili

Balil Balili – në radhë të parë më lejoni t’ju falenderoj për prezencën tuaj në këtë takim konsultativ për prezantimin e Paketës Fiskale për vitin 2022. Në këtë takim të sotëm janë edhe Seretari i Përgjithshëm i Bashkisë z. Shkëlqim dhe Drejtori i Taksave Vendore z.Astrit, të cilët do të na prezantojnë materialin e përgatitur për Paketën Fiskale. Unë do t’ju lutesha që pas prezantimit të paketës nga ana e drejtorit të Taksave në bashki, mund t’i drejtoni pyetje ekzekutivit lidhur mbi cdo paqartësi apo sygjerim tuajin. Fjala është për ekzekutivin

Shkëlqim Beqiraj - më lejoni t’ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ lidhur mbi prezantimin e projekt dokumentain “të Paketës Fiskale 2023” ku është një dokument që prezanton taksat dhe tarifat për një periudhë një vjecare. Pas prezantimit të paketës Drejtori i të Ardhurave në bashki do të bëjë një përmbledhje të ndryshimeve të draft dokumentit në krahasim me paketën fiskale që është akoma në fuqi deri në fundin e vitit aktual.

Astrit Murati – faleminderit, Përpara se unë t’ju prezantoj paketën fiskale për vitin 2023 dua të theksoj se Bashkia Patos parashikon për vitin 2023 një paketë fiskale gjithëpërfshirëse dhe sociale. Gjithmonë vëmendja e Bashkisë Patos qëndron në lehtësimin e taksave dhe tarifave familjare për grupe të vecanta me lehtësirat dhe përjashtimet përkatëse edhe pse peshën më të

madhe të taksapaguesve e mban biznesi i vogël apo i madh qoftë ai të cilët janë dhe kondtrbuesit kryesor pasi një paketë fiskale e realizuar në masëm 100% përkthehet në një buxhet më të mirë dhe më të plotë duke na dhënë ne mundësi për të patur më shumë investime në zonën tuaj të banimit.

Asteit Murati – Preznaton draft dokumentin e Paketës Fiskale për vitin 2023 për Njësinë Administrative Ruzhdie

Balil Balili – faleminderit për prezantimin, pyetje apo sygjerime?

Nuri Gllava - – po për familjet të cilat janë në veshtirësi ekonomike dhe nuk kanë mundësi për pagesë si do të veprohet?

Shkëlqim Beqiraj – patojetër që bashkia ka menduar lehtësira për familjet të cilat janë në vështirësi pasi ashtu sic dhe u vu theksi qysh në fillim nga Astriti bashkia jonë është një bashki sociale dhe padiskutim që edhe paketa fiskale do të jetë sociale.

Nuri Gllava – do të doja konkretisht cfarë keni parashikuar ju?

Astrit Murati – kur flasim për paketën fiskale padiskutim që mendja të shkon se sa të ardhura mbildhen nga taksat dhe tarifatat por për hir të së vërtetës grumbullimi i të ardhrave lidhur mbi taksën familjare lë për të dëshiruar pasi derdhjet e taksave dhe tarifave familjare nuk janë në nivelin e optimal për shumtë arsye të ndryshme. Përsëherë kemi familje taksapagues të cilët janë larguar për shkak të emigrimit dhe padyshim që ky fenomen nuk është në favor të bashkisë. Gjithsesi Bashkia Patos ka ofruar për komunitetin lehtësira dhe përjashtimet përkatëse më qëllim rritjen e arkëtimit.

Lehtësirat kryesore janë:

- Afati i pagesës i shtrirë gjatë gjithë vitit tatimor
- Pagesë me këste të detyrimeve për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare për pagesë të plotë të detyrimit
- Mos aplikimi i gjobave për komunitetin.

Përjashtimet nga taksat dhe tarifave vendore për grupe të vecanta:

- Përjashtim nga taksa e ndërtesës pensionistët të cilët në përbërjen e tyre familjare rezultojnë vetëm dhe banesa apo objekti është në emër të tyre
- Përjashtim nga taksa e ndërtesës kryefamiljarët që janë në skemën e ndihmës ekonomike dhe banesa apo objekti është në emër të tyre

Përjashtim nga tarifatat vendore për grupe të vecanta::

- Familjet e të persëkutuuarve politikë
- Familjet e veteranëve të luftës
- Familjet e invalidëve të të gjitha kategorive
- Pensionistët të cilët në përbërjen e tyre familjare rezultojnë të vetëm
- Kryefamiljarët të cilët janë në skemën e ndihmës ekonomike

Myftar Soraj – ajo që ju thatë është tepër e vertetë pasi taksat dhe tarifatat vendore janë detyrime ligjore por për fshatin Siqecë është një problem tepër i madh pasi familjet janë të larguara ndaj bashkia duhet të gjenden mekanizma për grumbullimin e taksës së tokës.

Dylber Laci – unë e kam kërkuar qysh në mbledhjen e mëparshme që për fshatin Kasnicë dhe Siqecë Bashkia të ofrojë shërbimin e pastrimit me qëllim që të kemi mundësi për vjeljen e sa më shumë taksave të popullatës

Myftar Soraj – Bashkia duhet të gjejë mekanizma për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore. ne dua të dimë konkretisht se cafrë do të bëhet pasi vetëm fjalë po dëgjojmë. Si Kryetari i Siqecës, dy problemet madhore të ngritura në vazhdimesi kanë qenë ajo e furnizimit me ujë të pijshëm dhe azhurnimi i tokave.

Teuta Mesdulaj – problemi i ujit të pishëm është tepër serioz pasi nuk kemi as ujë për të pirë dhe as ujë për vadiqe të tokave.

Vullnet Dervishaj - në radhë të parë dua t'ju përgëzoj për prezantimin e bërë për paketën fiskale pasi është dhe e dukshme se kjo paketë është në ndihmë të banorëve të Ruzhdies. Sic e thatë edhe ju, peshën më të madhe e mbajmë ne , bizneset familjarë të zonës, por edhe ju duhet të shikoni mundësinë për ofrimin e sa më shumë shërbimeve dhe investimeve sidomos në infrastrukturën rrugore

Balil Balili – ne si këshill të gjitha sygjerimet tuaja do tja paraqesim Kryetares së Bashkisë. Ndonjë sygjerim apo kërkesë lidhur mbi paketën fiskale? M.Q.Se jo unë ju falenderoj për prezencën tuaj dhe në dhjetor ne do të jemi përsëri së bashku për prezantimin e buxhetit për vitin 20213 dhe Buxhetin aftatmesëm.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Balil BALILI

Konceptoi:

Koord. Konsultimin Publik

Suzana HYSENAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Ruzhdie me 26.10.2022

LISTË PREZENCË MBI:
"DISKUTIMIN E PROJEKT DOKUMENTIT TË PAKETËS FISKALE 2023"

Nr	Emër	Mbiemër	Njësia Fshati	Institucioni / Subjekti	pozicion Profesion	Nr. Kontakti	Firma
1	Salo Myftaraj	Ruzhdie	Njeria Ruzhdie	Njeri rr -	hap. taktive	06992123510	
2	Orkber Laci	Ruzhdie	Njeria Ruzhdie	Bem	Forme	06884377723	
3	Hygjeut ruzhdie	Ruzhdie	Njeria Ruzhdie	Njeri rr -	hap. taktive	06992123510	
4	Myftoe Semyi	Ruzhdie	Njeria Ruzhdie	Njeri rr -	hap. taktive	06992123510	
5	Teuta Mehillaj	Ruzhdie	Njeria Ruzhdie	Njeri rr -	hap. taktive	06992123510	
6	Shkelqim Beqiri	Ruzhdie	Njeria Ruzhdie	Njeri rr -	hap. taktive	06992123510	
7	Balil Balliu	Ruzhdie	Njeria Ruzhdie	Njeri rr -	hap. taktive	06992123510	
8	Armi Ullashtas	Ruzhdie	Njeria Ruzhdie	Njeri rr -	hap. taktive	06992123510	
9	Armi Ullashtas	Ruzhdie	Njeria Ruzhdie	Njeri rr -	hap. taktive	06992123510	
10	Armi Ullashtas	Ruzhdie	Njeria Ruzhdie	Njeri rr -	hap. taktive	06992123510	
11	Armi Ullashtas	Ruzhdie	Njeria Ruzhdie	Njeri rr -	hap. taktive	06992123510	
12	Armi Ullashtas	Ruzhdie	Njeria Ruzhdie	Njeri rr -	hap. taktive	06992123510	

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale", Neni 10 "Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore" I të dhënave personale të mbledhura për çfarëdoq qëllimi, mund të përpunohen më tej vetëm për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Përpunimi i të dhënave personale lejohen të përdoren vetëm për qëllime gazetare, literare ose artistike. Përfshihen nga zbatimi i nenëve 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes



Ruzhdie me 26.10.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

LISTË PREZENCË MBI:
"DISKUTIMIN E PROJEKT DOKUMENTIT TË PAKETËS FISKALE 2023"

Nr	Emër	Mbiemër	Njësia Fshati	Institucioni / Subjekti	Pozicion Profesion	Nr. Kontakti	Firma
1	Miljon	Nikolla	Dukas	Bobkida	Sq. Prokurimi	0698160847	
2	Anisa	Kripa	Patos	B. Patos	Sq. Integrimi	0692897019	
3	Olujana	Gropa	Patos	B. Patos	Koordinatori p.k. p.k.	0699490612	
4	Aleri	Gllary	Patos	It. Shkolit	Gj. imazh	0682904147	
5	Valdet	Dennis	Patos	B. Patos	Specialiste	0698148052	
6	Jesli	Xhelaj	Patos	B. Patos	Specialiste	0684770444	
7							
8							
9							
10							
11							
12							

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale", Neni 10 "Pëpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore" I të dhënave personale, të mbledhura për çfarëdolloj qëllimi, mund të përpunohen më tej vetëm për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ.. Pëpunimi i të dhënave personale lejohet të përdoren vetëm për qëllime gazetare, literare ose artistike. Përshtohet nga zbatim i nenëve 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes